







## **Urtësia nga agjërimi i ditës së nëntë**

Imam Neveviu [rahimehull-llah] thotë:

Dijetarët kanë përmendur disa urtësi nga agjërimi i ditës së nëntë:

1- Disa kanë thënë se është përqëllim kundërshtimi i çifutëve dhe të krishterëve, të cilët e agjërojnë vetëm ditën e dhjetë. I këtij mendimi është Ibn abbasi dhe disa të tjerë.

2- Qëllimi është ndërlidhja e ashurasë me agjërimit, që mos të mbetet e vetmuar siç është rasti me xhumanë. Këtë e ka thënë Hattabiu dhe të tjerët.

3- Për të garantuar agjërimitin e ditës së dhjetë, pasiqë mundet ta gabojmë hyrjen e muajit, nga shkak i mosparjes së hënës në fillim të muajit.

Mendimi më i fuqishëm është kundërshtimi i Ehli Kitabit.

Shejhul-Islam ibn Tejmii [rahimehull-llah] thotë:

“Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka ndaluar përgjajësimin me ithtarët e Librit në shumë hadithe, prej tyre është edhe rasti me agjërimitin e ditës së ashura, ku thotë: “Po të jetoja deri në vitin e ardhshëm do ta agjërojë edhe ditën e nëntë”. (“Fetaval-Kubra”, vëllimi i gjashtë).

## **A lejohet veçimi i ashurasë me agjërimit**

Shejhul-Islam Ibn Tejmii ka thënë:

“Agjërimiti i ditës së ashurasë i shlym mkatet e një vitit dhe nuk urrehet të veçohet me agjërimit...”. (“Fetaval-Kubra”, vëllimi i pestë).

Këtë e thotë edhe Ibn Haxher Hejtemiu.

Nëse dita e ashurasë bjer në ditën e xhuma ose të shtunë, ç’duhet bërë në këtë rast?

Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth kësaj çështje. Disa e lejojnë, duke u mëbshtetur në argumentet e përgjithshme, sidomos ato argumente që kanë të bëjnë me ditën e xhuma. Ose e ka pasur të zakonshme agjërimitin e një ditë dhe ngrënien e ditës tjetër.

Këtë e thonë edhe në lidhje me agjërimitin e ditës së shtunë.

Mirëpo disa dijetar të tjerë, prej tyre është edhe Shejh Albani, [rahimehull-llah], janë të mendimit se nëse këto adhurime binë në ditën e shtunë, duhet ndaluar nga agjërimiti, sepse Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

???????? ?????????? ?????????????? ????????? ?????????????????? ????????? ?????? ?????????  
????????????????????

“Mos agjëroni shtunën përveç se kur e keni obligim”. (Ahmedi dhe të tjerët. Kurse Hakimi thotë se është sipas kushteve të Buhariut).

### **Cilat mëkate i shlyen agjërimi i ashurasë**

Imam Neveviu [rahimehull-llah] thotë:

“Agjërimi i ashurasë i shlyen të gjitha mëkatet e vogla. Domethënia është i shlyen të gjitha mëkatet, përveç mëkateve të mëdha”.

Vazhdon e thotë:

“Agjërimi i ditës së Arafatit, i shlyen mëkatet për dy vjet, kurse agjërimi i ashurasë për një vjet, e nëse përputhet amini i njeriut me të melaqeve, i shlyen mëkatet që i ka bërë më herët...Të gjitha këto gjëra të përmendura vlejné për të shlyer mëkatet. Nëse gjejnë ndonjë mëkat të vogël e shlyejné, e nëse nuk ka mëkate as të vogla e as të mëdha, atëherë i shkruhen sevape dhe i ngriten shkallët...e nëse ka ndonjë mëkat të madh, e nuk ka mëkate të vogla, shpresojmë t'ia lehtësojë mëkatet e mëdha”. (“El-Mexhmu”, vëllimi i 6).

Shejhul-Islam Ibn Tejmii [rahimehull-llah] thotë:

“Shlyerja e mëkateve me abdest, me namaz, me agjërim të Ramazanit, me agjërim të Arafatit, të ashurasë, është vetëm për mëkate e vogla”. (“Fetaval-Kubra”, vëllimi i 5).

### **Nuk duhet mashtruar me shpërblimin e këtij agjërimi**

Disa njerëz mashtrohen kur mbështeten në agjërimin e ditës së Ashurasë ose të ditës së Arafatit, saqë disa thonë: agjërimi i ashurasë i shlyen mëkatet e tërë vitit, kurse agjërimi i ditës së Arafatit është shpërblim i tepruar.

Ibn Kajjimi [rahimehull-llah] thotë: “Ky njeri i mashtruar nuk e di se agjërimi i Ramazanit, falja e pesë kohëve të namazit, janë më të mëdha dhe më me peshë se sa agjërimi i ditës së arafatit dhe ditës së Ashurasë. Kur këto dy adhurime i shlyejné mëkatet që bëhen mes tyre, nëse largohet nga mëkatet e mëdha. Ashtuqë Ramazani deri në Ramazan, xhumaja deri në xhuma, nuk kanë fuqi të shlyejné mëkatet e vogla nëse nuk ia shoqërojnë edhe largimin nga mëkatet e mëdha, që me këto dy veprimet, të ketë mundësi t'i shlyej ato mëkate. Disa të mashtruar mendojnë se veprat e tija të mira janë më shumë se mëkatet e tija, sepse ky nuk e ka llogaritur vetveten në mëkate e as që ka numëruar mëkatet e tija. Ky njeri kur e ka bërë një vepër të mirë, e ka ruajtur dhe është kujdesur për te, ashtu sikurse ai që bën istigfar dhe tesbih me gjuhën e tij njëqind herë, kurse i përgojon dhe shkyen nderin e muslimanëve, flet gjëra të cilat nuk e kënaqin All-llahun [subhanehu ve teala] gjatë tërë ditës. Ky njeri e shpreson shpërblimin e këtyre tesbiheve dhe istigfareve, e nuk shikon denimin e përgojimit, gënjeshtërs dhe bartjes së fjalëve. Kjo është një mashtrim shumë i madh”. (“Meusuatul-Fikhije”, vëllimi 31, kapitulli mi mashtrimin).

### **Agjërimi i Ashurasë, për ate që i ka mbetur nga Ramazani**

Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth kësaj teme. Dijetarët hanefit mendojnë se është e lejuar agjërimi i ashurasë, edhe pse të kanë mbetur ditë të pakopmenguara të Ramazanit, sepse kompensimi nuk është obligim momental. Kurse malikitë dhe shafiiitët mendojnë se është e lejuar, mirëpo nuk është e pëlqyer, sepse me këtë veprim e vonon obligimin. Kurse hanbelitë janë të mendimit se është i ndaluara agjërmi vullnetar pa e kryer atë obligativ. (“Meusutaul-Fikhije”, vëllimi 28, kapitulli i agjërimit vullnetar).

Sidoqoftë, muslimani duhet të nxitojë në agjërimitin e ditëve të mbetura nga Ramazani, që mos të ketë probleme, gjatë agjërimit të këtyre ditëve.

Nëse agjëruesi i agjëron këto ditë me nijet të kompensimit, këto ditë i vlejné në kompensimin e atyre ditëve që i kanë mbetur.

### **Bidatet e Ashurës**

E kanë pyetur shejhul-Islam Ibn Tejmion [rahimehull-llah] për ato veprime që i bëjnë njerëzit në ditën e ashurasë, siç është lyerja e syve me syrme, larja, përdorja e kënasë, përçafimi, përgaditja e ashures, gëzimi, etj. Këto veprime a kanë bazë në hadithe të Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ose jo? Nëse nuk ka hadith të vërtetë për këto veprime, veprimi i këtyrë gjërave a është bidat ose jo? Pastaj veprimet që i bëjnë disa sekte, siç është mbajtja zi, mërzia dhe etja, bërtitja dhe vajtimi, etj. Këto veprime a kanë bazë ose jo?

Është përgjigjur kështu:

E falënderoj All-llahun, Zotin e botërave.

Për këto veprime nuk ka asnjë hadith të vërtetë nga Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e as nga shokët e tij. Këtë nuk e pëlqen asnjë imam prej imamëve të muslimanëve, as katër imamët e as të tjerët. Dijetarët e besuar nuk i kanë përmendur këto gjëra në librat e tyre, as si transmetime nga Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e as nga shokët e tij, e as nga tabiinët, as transmetime të vërteta e as të dobëta. As në librat e haditheve të vërteta e as në sunene e as në musnede. Këto gjëra nuk kanë qenë të njohura në kohën e shekujve të vlefshëm. Mirëpo disa të mëvonshëm i kanë transmetuar disa hadithe të ndryshme...(këtu i përmedn disa hadithe të tilla). të gjitha këto transmetime janë gënjeshtër mbi Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. (pastaj përmendi shkurtimisht telasht që kanë ndodhur në fillim të Islamit, mbi vrasjen e Husjenit [radijall-llahu anhu], edhe çka kanë bërë sekte të ndryshme për shkak të këtyre ndodhive, që në vijim të thotë:

“Ashtu që një sektë injorante dhe zullumqare të bëhet: ose e pafe dhe dyfytëshe, ose e lajthitur dhe e humbur, e cila publikon dashurinë ndaj tij dhe ndaj ehli bejtit, të cilët ditën e ashurasë e konsiderojné ditë zie, pikëllim dhe mërzi. Në këtë ditë bëjnë veprime të xhahilijetit duke i shkyer rrobat, duke rrahur trupin, etj. Prej zburimeve të shejtanit para njerëvze të humbur ka qenë shndërrimi i ditës së ashurasë në ditë zie dhe pikëllimi, ku vajtojnë dhe recitojnë poezi mërzie. Në këtë ditë transmetojné shumë tregime të rrejshme, ku ska aspak vërtetësi, përveç ripërtërirjes së mërzisë, fanatizmit, nxitjes së urrejtjes dhe luftës, përhapjes së telasheve mes muslimanëve, që të arrijné në sharrjen dhe ofendimin e muslimanëve të parë...Dëmin e tyre për muslimanët nuk mundet ta tregon as njeriu më orator. Përballë tyre janë ose nasibitë, të cilët

janë kundër Husjenit [radijall-llahu anhu] dhe ehli bejtit ose injorantët të cilët të keqen e përballojnë me të keqe, gënjeshtren me gënjeshtër, çorodinë me çorodi, bidatin me bidat. Këta njerëz publikojnë gëzimin dhe harenë në këtë ditë, duke u zbukuruar me syrme dhe këna, duke harxhuar me tëpër pasuri në këtë ditë, duke përgaditur ushqëime jo të zakonshme, e shumë gjëra tjera që bëhen zakonisht në festa dhe raste festive. Këta njerëz ditën e ashurasë e konsiderojnë një festë prej festave, kurse ata të parët ditë zie dhe pikëllimi. Që të dy këto palë janë në gabim dhe kanë dalur jashat sunnetit, edhe pse të parët e kanë qëllimin më të keq, kanë injorancë më të madhe dhe bëjnë zullum më të madh...

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e as hulefatë e tij të drejtë nuk i kanë bërë këto gjëra në ditën e ashurasë, nuk kanë publikuar as mërzi dhe pikëllim e as gëzim dhe hare...

Kurse sa u përket gjërave tjera, siç është përgaditja e ushqimeve jo të zakonshme, ashure ose ushqim tjetër, veshja e rrobave të reja, zgjërimi në harxhime, blerja e nevojave të tërë vitit në këtë ditë, bërja e ndonjë adhurimi të veçantë, siç është falja e ndonjë namazit të veçantë për këtë ditë, ose therja, ose deponimi i mishit të kurbanit që të përgaditet ushqim në këtë ditë, syrmosja dhe përdorimi i kënasë, larja dhe përqafimi, vizitat reciproke ose vizita e ndonjë xhamie ose tyrbeje, etj, tërë këto gjëra janë bidate të urrejtura, të cilat nuk i ka lërë sunnet Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e as halifet e tij të drejtë. Këto gjëra, nuk i konsideron të pëlqyeshme snjë imam i muslimanëve, as Maliku, e as Theuriu, as Lejth ibn Sadi e as Ebu Hanifeja, as Evzaiu e as Shafiu, as Ahmedi e as Is'hak ibn Rahavjehu, e as imamët dhe dijetarët tjerë të muslimanëve". (Fetaval-Kubra).

E lusim All-llahu e lartmadhërishtëm që të na bëjë nga ithtarët e sunnetit, të na ngjallë në Islam dhe të na e mer shpirtin me Iman, të na drejtojë kah veprat që i do dhe i pëlqen. E lusim ate të na ndihmojë që ta përmednim, ta falënderojmë dhe mirë ta adhurojmë. E lusim ate që të na i pranojë veprat dhe që të na bëjë nga të devotshmit.

Paqa dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin, familjen dhe shokët e tijë.

Përgaditi <http://www.islam-qa.com/>

Përshtati: Bekir Halimi